



Влада на Република Северна Македонија

Në bazë të nenit 19 paragrafi (7) të Ligjit doganor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 39/05, 4/08, 35/10, 48/10, 158/10, 44/11, 53/ 11, 11/12, 171/12, 187/13, 15/15, 129/15, 154/15, 192/15, 23/16, 144/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më -----të vitit 2023, miratoi

**VENDIM**  
**PËR ULJEN E TAKSAVE TË IMPORTIT**  
**PËR IMPORTIN E AGRUMEVE, TË FRESKËTA OSE TË THARA**

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet masa për heqjen e taksës së importit – normë doganore dhe taksa të veçanta gjatë importit të agrumeve, të freskëta ose të thara, edhe atë:

Numri i kuotës	Shenja tarifore	Përshkrim	Sasia (во kg)
097303	0805 0805 10 0805 21 0805 22 00 00 0805 29 00 00 0805 40 00 00 0805 50	Agrume, të freskëta ose të thara: - Portokall: - Mandarina (duke përfshirë tangerina dhe satsuma); klementina, uilking dhe hibride të ngjashme të agrumeve: -- Mandarina (duke përfshirë tangerina dhe satsuma): -- Klementina -- Tjetër - Grejpfrut dhe pomelo - Limona ( <i>Citrus limon</i> , <i>Citrus limonum</i> ) dhe limeta ( <i>Citrus aurantifolia</i> , <i>Citrus latifolia</i> ):	2.000.000



Влада на Република Северна Македонија

Neni 2

Sasia e mallrave të përmendura në nenin 1 të këtij vendimi do t'u shpërndahet importuesve të regjistruar të pemëve sipas parimit “i pari i ardhur, i pari i shërbyer”.

Neni 3

Mallra nga neni 1 i këtij vendimit do të importohen deri më 31 dhjetor të vitit 2023.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ne ditën e nesërme nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. _____ ____shtator të vitit 2023 Shkup		Kryetar u Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, dr. Dimitar Kovačevski, n.p.
---	--	---



Влада на Република Северна Македонија

ARSYETIM

Me këtë vendim propozohet heqja e përkohshme e taksave të importit – normave doganore dhe taksave të veçanta për importin e agrumeve, të freskëta apo të thata, për sasi prej 2 000 000 kg. edhe atë:

- taksa e importit prej 0,03 euro/kg (maksimumi 10%) për portokallet (numri tarifor 0805 10)
- taksa e importit prej 0,04 euro/kg (maksimumi 10%) për mandarinat (duke përfshirë tangerinat dhe satsumat); klementinë, uilking dhe hibride të ngjashme të agrumeve (numër tarifor 0805 21 dhe shenjat tarifore 0805 22 00 00 dhe 0805 29 00 00)
- norma doganore 10% për grejpfrut dhe pomelo (shenja tarifore 0805 40 00 00)
- norma doganore prej 15% për limonët (Citrus limon, Citrus limonum) dhe limetë (Citrus aurantifolia, Citrus latifolia): (numri tarifor 0805 50)

Propozim vendimi për heqjen e taksave të importit – normave doganore dhe taksave të veçanta për importin e agrumeve, të freskëta apo të thara, propozohet me qëllim të uljes së çmimeve të këtyre produkteve në vend dhe të mbrojtë standardin jetësor të qytetarëve.

Importi i këtyre produkteve bëhet pa doganë nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendet anëtare të CEFTA-s, e sipas Marrëveshjes së tregtisë së lirë me Turqinë, është përcaktuar kuotë importi pa doganë prej 8 000 000 kg. dhe me doganë të paguar nga vende të tjera.

Në përputhje me të dhënat statistikore për vitin 2022 është realizuar import i 30.712 tonë agrume me vlerë prej 14. 611. 376 euro. Nga gjithsej 30.712 tonë agrume të importuara pa doganë, 22.538 tonë janë importuar , ndërsa për 8.175 ton është paguar doganë. Importet sipas produkteve dhe importet sipas vendeve janë dhënë më poshtë në pasqyrat.

Pasqyrë e importit të agrumeve, të freskëta ose të sharanë vitin 2022

	<i>Sasia në kg.</i>	<i>Vlera në euro</i>
<i>Portokall</i>	<i>12.097.260</i>	<i>4.962.486</i>
<i>Mandarinë</i>	<i>9.288.916</i>	<i>4.754.080</i>
<i>Grejpfrut</i>	<i>978.271</i>	<i>423.587</i>



Влада на Република Северна Македонија

<i>Limona</i>	8.347.964	4.471.223
<i>GJITHSEJ</i>	30.712.411	14.611.376

*Pasqyrë e importit të argumeve, të freskëta ose të thara sipas vendeve në vitin 2022*

	<i>Sasia në kg.</i>	<i>Vlera në euro</i>	<i>Pa doganë (sasia)</i>	<i>Me doganë (sasia)</i>
<i>BE</i>	13.168.805	4.962.486	13.168.805	
<i>Turqi</i>	12.834.451	4.754.080	8.000.000	4.834.451
<i>CEFTA</i>	1.368.927	423.587	1.368.927	
<i>Vende të tjera</i>	3.340.228	4.471.223		3.340.228
<i>GJITHSEJ</i>	30.712.411	14.611.376	22.537.727	8.174.679

Në tremujorin e fundit të vitit 2022 janë importuar 9.920 tonë agrume në vlerë prej 5.159.525 euro. Çmimi mesatar i importit ishte 0.52 euro për kg. Më poshtë është dhënë pasqyrë e importeve të agrumeve në tremujorin e fundit të vitit 2022.

*Pasqyrë e importit të argumeve, të freskëta ose të shara në periudhën 1.10.2022 deri më 31.12. të vitit 2022*

	<i>Sasia në kg.</i>	<i>Vlera në euro</i>	<i>Struktura e importit (%)</i>	<i>Çmimi mesatar i importit</i>
<i>Portokall</i>	2.521.109	1.211.875	25,4	0,48
<i>mandarina</i>	5.285.941	2.757.856	53,3	0,52
<i>Grejpfrut</i>	189.256	115.716	1,9	0,61
<i>limona</i>	1.923.820	1.189.678	19,4	0,62
<i>GJITHSEJ</i>	9.920.126	5.159.525	100,0	0,52



Влада на Република Северна Македонија

*Implikimet fiskale nga miratimi i këtij vendimi do të arrinin në rreth 97.763 euro të përlogaritura sipas çmimeve mesatare të realizuara në tremujorin e fundit të vitit 2022 dhe në përputhje me strukturën e importit të realizuar në tremujorin e fundit të vitit 2022.*

*Përlogaritja e implikimeve fiskale*

	Sasia	Çmimi mesatar	Vlera	dogana		
	në kg.	në euro	në euro	Taksa e veçantë	Max (%)	
<i>portokall</i>	508.282	0,48	243.975	15.248	24.397	15.248
<i>mandarina</i>	1.065.700	0,52	554.164	42.628	55.416	42.628
<i>grejpfрут</i>	38.156	0,61	23.275		3.816	3.816
<i>limona</i>	387.862	0,62	240.474		36.071	36.071
<i>GJITHSEJ</i>	<i>2.000.000</i>	<i>0,52</i>	<i>1.061.888</i>			<i>97,763</i>